**V E N D I M**
**Nr. 81, datë 6.2.2003**

**PËR SHITJE TRUALLI, KISHËS ORTODOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË**

*(Ndryshuar me VKM nr. 241 datë 23.4.2004)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b" të nenit 3 e të paragrafit të parë, të nenit 8 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. *Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë i shitet trualli me sipërfaqe prej 1079 m$^2$, në pjesën lindore të pronës së kësaj kishe, në qytetin e Tiranës, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*

2. Çmimi i shitjes së truallit të jetë 1 600 lekë/m2.

*2/1.Të ardhurat, që realizohen nga shitja e truallit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të derdhen në Buxhetin e Shtetit.*

3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

*(Shtuar tabela me VKM nr. 241 datë 23.4.2004)*


5Kt
"Deshmoret e 4 Shkurtit"
St2
94,2
St1
1079 m2
50,73
Ministria e
Bujqesise
3+1Kt
SIPERFAQJA QE I JEPET
KISHES ORTHODHOKSE SIPAS
STUDIMIT TE RI URBANISTIK
APROVUAR NGA K.RR.T.SH.
58,28
6,14
90,87
St3
Ministria e Mrojtjes
2+1Kt
Ing. Dionis Bello
Nr. Lic. K-0347/2